

**Dioqeza e Lezhës
Famullia e Shënkollit**

PASHKA 2020 - JAVA E SHENJTË NË KOHËN E PANDEMISË NGA KORONAVIRUS



Në javën e shenjtë (5-12 prill) kremtojnë Mundimin, Vdekjen dhe Ringjalljen: Pashkën e Jezusit, Festa më e madhe e Krishtërimit. Këtë vit për shkak të pandemisë të koronavirusit nuk do të kemi kremtime publike. Le të ndjekim si të krishterë, nga shtëpia në familje ritet pashkërore nëpërmjet Web (facebook: <https://www.facebook.com/famullia.shenkoll.1>)

5 Prill. E Diela e Larit

Ora: 9.30

Këtë të dielë është hyrja në Pashkën e Zotit, për të cilën jemi duke u përgatitur në Krezhme. Jezusi hynë në Jeruzalem i festuar nga populli. Le ta shoqërojmë me fe Shpëtimtarin tonë dhe i kërkojmë që ta ndjekim deri në fund të kryqit, për të qenë pjesmarrës në ringjalljen e tij.

Turmat e Hebrenjëve, duke sjellur degë ullinjësh, i shkonin në takim Zotit dhe brohorisnin me zë të lartë: Osanna në më të lartin qiell.

Leximi i Mundimit të Zotit: Mt 26, 27.

Të lutemi

O Hyj i gjithëpushtetshëm dhe i amshuar, që ju ke dhënë si model njerëzve Krishtin Birin tënd, Shpëtimtarin tonë, i bërë njeri dhe i përvujtëuar deri në vdekje në kryq, bëj që ta kemi gjithmonë parasysh mësimin e madh të mundimeve, për ta marrë pjesë në lumturinë e ringjalljes. Nëpër Krishtin Zotin tone. Amen.

9 prill. E Entja e madhe – Përkujtim i darkës së Zotit

Ora: 17.00

Në kremtimin liturgjik të darkës, duke përkujtuar darkën e fundit të Jezusit, kujtojmë themelimin e Eukaristisë dhe të

Meshtarisë.

Ky është trupi im, që është për ju;

ky është kelku është beslidhja e re në gjakun tim. Bëni këtë çdo herë në përkujtimin tim.

Lexim i Ungjillit të Gjonit (13,1-15)

I deshi deri në vdekje.

Të lutemi

O Hyj, kremtojmë darkën e Shentë në të cilën biri yt i vetëm, para se të dorëzohej në vdekje, i besojë Kishës sakrificën e re të të amshuar, tryeza martesore e dashurisë së tij, bëj që nga pjesmarrja në një mister kaq të madhë të mund të jemi pjesmarrës në banketin tënd qiellor. Nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.

10 prill. E Premtja e Madhe. Kujtim i Mundimit dhe vdekjes se

Ora: 15.00

Në orët e pasditës kremtohet Mundimi i Zotit me lutjen universale të adhurimit të kryqit.

Për ne Krishti është bërë i dëgjueshëm deri në vdekje dhe deri në vdekje në kryq.

Për këtë Hyji e ka lartësuar dhe i ka dhënë emrin që është mbi çdo emër.

Lexim i Mundimit të Jezusit sipas Gjonit (Gjn 18).

Të lutemi sot për Kishën e Shenjtë të Hyjit: Hyji na dhuroft bashkimin dhe paqen, e

liroft botën nga çdo rremujë: e largoft pandeminë, e largoft urinë, ju dhuroft lirinë të burgosurëve, të drejtën të shtypurëve, i dhasht sigurinë atyre që udhëtojnë, kthimin në shtëpi atyre që gjinden larg, shëndetin të sëmurëve, atyre që ndodhen në prag të vdekjes shpëtimin e amshuar.

Të lutemi

O Hyj, që në mundimin e Zotit tonë Jezu Krishtit na ke liruar nga vdekja, trashigimi e vjetër i mëkatit që i është tejçuar të gjithë njerëzimit, na ripërtijë në imazhin e Birit tënd; ashtu si mbajmë që nga lindja imazhin e njeriut tokësor kështu për veprën e Shpirtit Shenjtë të mund të kemi në ne imazhin e njeriut qiellor. Nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.

11 Prill. E shtunja e Madhe,

Ora: 22.00

Në këtë natë të Shenjtë, në të cilën Jezu Krishti Zoti ynë kaloi nga vdekja në jetë, Kisha i thërret bijtë e saj të rrinë zgjuar në lutje.

Rijetojmë Pashkët e Hyjit në dëgjimin e Fjalës, me ripërtëritjen e Pagëzimit tonë dhe me pjesëmarrjen në Eukaristi. Krishti i ringjallur do të konfirmojë në ne shpresën për të marrë pjesë në fitorën etij mbi vdekjen dhe për të jetuar me atë në Hyjin Atë.

Jezusi, i kryqëzuri është ringjallur, ashtu si ki-

shte thënë. Alleluia.

Lexim i Ungjillit sipas Mateut (28,1-10).

Të lutemi

O Hyj, që e shndrit këtë natë të shenjtë me lavdinë e ringjalljes së Zotit, gjallëro në familjet tona dashurinë tënde, që të gjithë bijtë e tu, të ripërtërirë në trup dhe në shpirtë, të jenë gjithmonë besnik në shërbimin tënd. Nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.

Ora: 9.30

12 Prill. E Diela e Pashkëve.

Ashtu si gratë tek varri, vëmë re varrin bosh. Krishti është ringjallur e jeton me ne!

*Zoti është vërtetë Ringjallur. Alleluia!
Atij Lavdi e nder !*

Lexim i Ungjillit sipas Mt(28,1-10)

Të lutemi

O Hyj, që në këtë ditë, mëpërmjet Birit tënd të vetëm, e ke fituar vdekjen dhe na ke hapur kalimin në jetën e amshuar, na jep ne, që kremtojmë Pashkët e ringjalljes që të jemi të ripërtërirë në Shpirtin tënd, për të rilindur në dritën e Zotit të ringjallur. Nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.